



75 suli
Pfu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Eldoraj

Nr. 1399 prot.

Tiranë, më 20.3.2018

Lënda: Kërkesë për ripublikimin e një njoftimi për aplikim

**QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE
GJYKATËS KUSHTETUESE
GJYKATËS SË LARTË
KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË
DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERËVE
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
FAKULTETIT TË DREJTËSISË, UNIVERSITETI I TIRANËS**

Tiranë

**FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE-JURIDIKE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"**

Durrës

**FAKULTETIT TË DREJTËSISË
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"**

Shkodër

**FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE, DEPARTAMENTI I DREJTËSISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"**

Vlorë

Të nderuar,

Këshilli i Evropës i ka kërkuar qeverisë shqiptare të paraqesë listën me propozime për tri kandidaturat më të përshtatshme për pozicionin e gjyqtarit të ri të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), i cili votohet nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Me qëllim që njoftimi për paraqitjen e aplikimeve të jetë gjerësisht i shpërndarë, si dhe duke qenë se është shtyrë afati për paraqitjen e këtyre aplikimeve, lutemi në bashkëpunimin tuaj për ripublikimin e tij në faqen zyrtare të institucionit që ju drejtoni (njoftimi bashkëlidhur).

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Engjëll AGAÇI



NJOFTIM PËR APLIKIM

PËR ZGJEDHJEN E GJYQTARIT TË SHQIPËRISË NË GJYKATËN EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

(shtyhet afati i aplikimit, deri në datën 16 prill 2018)

Në funksion të pranimit të një numri sa më të lartë aplikimesh për pozicionin e gjyqtarit shqiptar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, afati i aplikimit shtyhet deri në datën 16 prill 2018.

Inkurajojmë të gjithë juristët që përmbushin kriteret e mëposhtme, të aplikojnë!

Këshilli i Evropës i ka kërkuar qeverisë shqiptare të paraqesë listën me propozime për tri kandidaturat më të përshtatshme për pozicionin e gjyqtarit të ri të Shqipërisë në GJEDNJ, i cili votohet nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Ky njoftim për aplikim bazohet në udhërrëfyesin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM (2012) 40-add, datë 29.3.2012. Mandati i gjyqtarit është për një afat prej 9 (nëntë) vjetësh dhe mbaron pas përfundimit të këtij afati ose kur ai/ajo arrin moshën 70 vjeç. Kandidatët, nëse zgjidhen, duhet të jenë në gjendje të mbajnë këtë detyrë për të paktën sa gjysmën e mandatit 9-vjeçar, para se të arrijnë moshën 70 vjeç.

Aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë arsim të lartë juridik;
- Të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e drejtësisë;
- Të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- Të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- Të ketë karakter të lartë moral, në përputhje me pikën 1, të nenit 21, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- Të zotërojë një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht), si dhe, së paku, të ketë njohuritë bazë të gjuhës tjetër. Do të konsiderohet përparësi zotërimi i të dyja gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:

- Kërkesë për aplikim;
- Kopje e letërnjoftimit;
- *Curriculum Vitae* në gjuhën shqipe dhe *Curriculum Vitae* të formatizuar sipas modelit në *link-un* e mëposhtëm, në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht):
<http://assembly.coe.int/CommitteeDocs/2009/ModelCVEN.doc>
- Dokumente të diplomimit dhe të kualifikimeve shkencore;
- Dokument që të provojë vjetërsinë në profesion;
- Dokumente që provojnë njohjen dhe zotërimin e gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës apo gjuhëve të tjera të huaja;
- Vetëdeklarim që është person i padënuar/dënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
- Vetëdeklarim se interesat private nuk përmbajnë burime të paligjshme financiare, fshehje të pasurive, deklarime të rreme apo konflikt interesi;
- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Vetëdeklarim se nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;

(Deklarimi i rremë, përveç përgjegjësisë penale sipas ligjit, sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.)

- Dokumente të tjera në funksion të përmbushjes së kriterëve të tjera plotësuese.
- **Duke marrë në konsideratë rëndësinë e integritetit profesional e moral, si dhe pastërtinë e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë shqiptare, por edhe të përfaqësuesve shqiptarë në trupat ndërkombëtarë gjyqësorë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, aplikantët për pozicionin e gjyqtarit të ri të Shqipërisë në GJEDNJ do t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar (*Vetting-ut*), si më poshtë:**

1. Aplikantët për pozicionin e gjyqtarit në GJEDNJ, që mbajnë funksionet e parashikuara nga pikat 3 dhe 4 (fjalía e parë), të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësohen *ex officio*, nga institucionet e rivlerësimit;
2. Aplikantët për pozicionin e gjyqtarit në GJEDNJ që vijnë nga radhët e ish-gjyqtarëve, ish-prokurorëve, ish-këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, do t'i nënshtrohen parimeve të pikës 3 të këtij njoftimi. Por, nëse dëshirojnë, mund të rivlerësohen nga institucionet e rivlerësimit, në përputhje me pikën 4 (fjalía e dytë), të nenit 179/b, të Kushtetutës;
3. Aplikantët e tjerë, profesionistë të së drejtës, që nuk përfshihen në kategoritë e përmendura në pikat 1 dhe 2, do t'u nënshtrohen parimeve që qëndrojnë në themel të procesit të rivlerësimit (*Vetting-ut*), të cilat lidhen me çështje të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit profesional, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

Shënim:

- Pas vlerësimit të dosjeve të aplikimit dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, aplikantët do t'i nënshtrohen intervistës, ku një pjesë e pyetjeve do të jenë në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht).

Afati i dorëzimit të aplikimit, deri më 16 prill 2018.

**Adresa: Kryeministria
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, 1000
Tiranë, Shqipëri**

**Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Tel.: 00355 4 22 77 401**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR

Vlore më 20 / 03 / 2018

Lënda: Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi:

Drejtuar:

Senati

Rektorati

Dr. Aurela Saliaj Dekan F. Sh. P.

Kryesekretare F. Sh. P.

Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E.

Kryesekretare F. E.

Prof. Asoc. Aleks Trushaj Dekan F. Sh. H.

Kryesekretare F. Sh. H.

Prof. Asoc. Hajdar Kicaj Dekan F. Sh. T.

Kryesekretare F. Sh. T.

Bordi i Administrimit

• **Administrator**

○ **Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese**

✓ Sektori I Finances dhe Realizimit te Buxhetit

✓ Sektori I Prokurimeve

✓ Sektori I Sherbimeve

• **Njesia e Auditit te Brendshem**

Zv. Rektor Për Kerkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional

• **Drejtoria e Sigurimit te Cilesise dhe Zhvillimit Institucional**

• Njesia e Sigurimit te Brendshem te Cilesise dhe Vleresimit Insitucional

• Sektori I Sherbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit

• Sektori I Projekteve dhe Marredhenieve me Jashte

• **Sektori I Promovimit Akademik dhe Kerkimeve Shkencore**

Zv. Rektor Akademik

• **Drejtoria e Edukimit per Ciklin e Pare dhe te Dyte**

○ Sektori I Kurikulave dhe Sherbimit ndaj Studenteve

○ Sektori I Keshillimit te Karieres Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive

○ Sektori I Bibliotekes Shkencore

• **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerezore**

○ Sektori I Burimeve Nerezore dhe Protokoll-Arkives

○ Sektori I Komunikimit dhe Marredhenieve me Publikun

Sektori Juridik

Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal

Prof. Dr. Roland Zisi

Rektori